



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
DREJTORIA JURIDIKE**

Nr _____ prot.

Vlorë, më _____2018

Komisioni i Procedurës së Monitorimit

Bazuar në nenin 7, gërma c të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike” me gjithë ndryshimet , Ligji nr .135/2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’ si dhe në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë me nr.73 , datë 17.07.2018, Bashkia Vlorë paraqet njoftimin e mëposhtëm për ‘Ftesë për Negociata”

Autoriteti kontraktues

Bashkia Vlorë,

me adresë.

Bashkia Vlorë
Sheshi “4 Heronjtë”, Vlorë, Shqipëri,
Vlorë, Shqipëri

Person kontakti

Z..Vladimir Zahaj

Pozicioni, Përgjegjës buxheti
Email.vladimir.zahaj@vlora.gov.al
Tel: 00 355 69 46 44 337

Znj. Jonela Gjinaj

Pozicioni : Juriste
Email: jonela.gjinaj@vlora.gov.al

Qëllimi i kontratës

Asistenca dhe përfaqsimi i Bashkisë Vlorë në procedurën e Gjykimit të sjellë përpara Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë për mosmarrëveshjet e lindura nga marrëveshja me Shoqërinë koncesionare.

Asistenca përfshin vlerësimin e situatës ligjore, përfaqësimin në procedurën e gjykimit dhe asistencën në rast negocimi.

Informacioni specifik në Procedurat e Arbitrazhit.

Duke ju referuar marrëveshjes së koncesionit, rezultton:

1. Numri i arbitrave duhet të jenë 3(tre).
2. Arbitrat duhet të caktohen në bazë të rregullave të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë
3. Vendi gjykimit/ Paris.
4. Gjuha e gjykimit, Anglisht.

Detyrimet e Avokatit dhe të Studios Ligjore.

1. Të studiojë të gjithë kontratën/ marrëveshjen e koncesionit, korespondencës dhe dokumentave të tjerë në lidhje me marrëveshjen koncesionare dhe diskutimet.
2. Për të vlersuar situatën eksistuese ligjore ndërmjet palëve dhe përgatisin një strategji për Republikën e Shqipërisë.
3. Të bashkëpunojë me ekspertin/ekspertët e zgjedhur nga Institucion Shtetëror i përshtatshëm, për teknika të ndryshme dhe vlerësime financiare, përpara dhe gjatë procesit të Arbitrimit.
4. Për të trajtuar cdo parashtesë, komunikim ose cdo dokument tjetër në Gjykatë, të marri pjesë në dëgjim dhe të përgatisi dëshmitarët.
5. Të vlerësojë Avokatin Shqiptar si Avokatë të përshtatshëm të kontratës/marrëveshjes së Koncesjonit.
6. Të asistojë Bashkia Vlorë në rast negocimi.

Kriteret e Përzgjedhjes

A. Kriteret e Përzgjedhjes

1. Avokati ose Studio Ligjore duhet të jetë e Specifikuar në gjykimin ndërkombëtarë të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.
2. Avokati ose Studio Ligjore duhet të jetë e mirë informuar dhe specializuar në fushën e përgatitjes së praktikave ligjore.
3. Avokati ose Studio Ligjore duhet të kenë eksperiencë të gjerë të përfaqësimit.

B. Kriteret Specifike

1. Avokati ose Studio Ligjore duhet të demostrojë sukses, të kenë pasur të paktën 2 rastë të ngjashme.
2. Avokati ose Studio Ligjore duhet të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 vite pune.
3. Avokati ,ose Avokatet e Studios Ligjore duhet të provojnë që kanë eksperiencë të gjerë në përfaqësimin e çështjeve ndërkombëtare duke iu nënshtruar rregullave të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë

Kriteret e Përzgjedhjes	Pikët
1.Specializimi në gjykimin ndërkombëtar sipas rregullave të ICC	25
2.Siguri/Reputacion	25
3.Eksperincë të gjerë në përfaqësimin e çështjeve të ngjashme	20
4.Të tregojë sukses(të pakten në 2 raste)në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mëparshme,ceshtje gjykimi para Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë	10
5.Ekperienca si Këshilltar/Avokat jo më pak se 5 vite nënshtruar rregullave të ICC	10

Kriteri i ofertës financiare, do të vlerësohet me pikët si më poshtë:

Kriteri Financiar	Pikët
1.Cmimi	10

Informacioni dhe Dokumentacioni që duhet të përmbajë oferta:

A.Informacioni

- a) Prezantimi i Studios Ligjore dhe detaje të specifikuar
- b) CV e Stafit e përkushtuar për realizimin e shërbimit
- c) Referenca të mira të kompetencave dhe eksperiencia në realizimin e shërbimit të ngjashëm
- d) Përshkrim të shkurtër të metodologjisë, veprimeve dhe afateve për ofrimin e shërbimit.

B. Kopje e dokumentave të mëposhtme:

- a. Lishenca e Avokatit
- b. Vertetim që Studiu ligjore operon sipas ligjeve në fuqi dhe nuk është objekt i likuidimeve,e falimentuar ose pjese e veprimeve që mund të dëmtojë shërbimin e ofruar.
- c. Deklarata që ska konflikt interesi

C. Cmimi

Cmimi për shërbimin duhet të shprehet në atë mënyrë që të mbulojë tarifën dhe duhet të përfshijë kompesimet e ofruesit dhe të tjera shpenzime.

Dokumentacioni do paraqitet në gjuhën shqipe/angleze.

Procedura e Përzgjedhjes

Komisioni i Procedurës së Monitorimit.

Komisioni i Procedurës së Monitorimit e themeluar në bazë të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë së Vlorës, është përgjegjës për përmbusjen e detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e vendimit nr.73, datë 17.07.2018.

Anëtarët e Komisionit janë:

1. Z. Shkelqim Rama (Kryetar)
Email : shkelqim.rama@vlora.gov.al
2. Z.Daut Zeraj (Anëtar)
Email : daut.zeraj@vlora.gov.al
3. Z.Sonela Haxhiraj (Anëtar)
Email : sonela.haxhiraj@vlora.gov.al
4. Z.Vladimir Zahaj (Anëtar)
Email : vladimir.zahaj@vlora.gov.al
5. Jonela Gjinaj (Anëtar)
Email : jonela.gjinaj@vlora.gov.al

Komisioni, ndër të tjera :

- Përgatit dokumentacionin
- Publikon ofertën për negociata
- Jep Sqarime për dokumentat e ofertës.
- Bën vlerësimin e ofertës
- Përgatit një raport të detajuar të procedurës,i cili është dërguar Kryetarit të Bashkisë, duke përfshirë klasifikimin e ofertueseve.

Komisioni komunikon në Anglisht me të Interesuarit për Ofertën.

B.Kërkesë Për Sqarime

Të interesuarit për ofertën mund të paraqesin kërkesat për sqarim në lidhje me ofertën për negociim deri në datën 24.07.2018, ora 10:00.

C.Parashtresa dhe hapja e ofertës.

Oferta së bashku me informacionin dhe dokumentacionin e përshatshëm duhet të dërgohen zyrtarisht me post në zarf të mbyllur me shënimin e mëposhtëm mbi të, “Përfaqësimi i Bashkisë Vlorë në ICC në çështjen e arbitrazhit kundër...”

Oferta duhet të dërgohet te adresa Bashkia Vlorë, Lagja ”4 Heronjtë”, Kati i 3, Vlorë, Shqipëri” **deri në datë 25.07.2018, ora 10:00**

Oferta duhet të hapet në datë 25.07.2018 ora 10:30 në prani të anëtarëve të komisionit.

KRYETARI

Dritan Leli

Konceptoi:*D.Zeraj*